



Prishtinë, 28 mars 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1122_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084);
- Nenin 19, 20 dhe 21 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Vendimit mbi Njoftimin për Autorizim Preliminar V_296_2010 të datës 11 nëntor 2010;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_568_2013 të datës 24 tetor 2013 lëshuar shoqërisë "KelKos Energy" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, HC Lumëbardhi II. në rrjedhën e lumit Deçan me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, ZK Deçan, komuna e Deçanit; dhe
- Kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V_568_2013 të datës 24 tetor 2013 për ndryshimin e kapacitetit instalues nga 5.5 MW në kapacitetin total instalues prej 6.2 MW për Hidrocentralin HC Lumëbardhi II., që është ndërtuar në ZK Deçan, Komuna e Deçanit, të datës 07.12.2018 të shoqërisë "KelKos Energy" SH.P.K., me adresë rruga "Sali Ceku" Nr. 14 -51000 Deçan, Republika e Kosovës;
- Vendimi nr. 3681-3/18 –ZSP- /2018 të datës 13.11.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1839/11 – ZSP- 229/13 dt. 19.03.2013 për HC Lumëbardhi II., nga N= 5.5 MW në kapacitetin e ekzekutuar N= 6.2 MW të lëshuar nga MMPH; dhe
- Raportin e Reviduar 3 si vlerësim i ndërtimit, amendamentimin e Dizajnit të ndërtimit të HC Lumëbardhi II dhe Projektit Kaskad Hidrologjik i Lumëbardhit të Deçanit,

në seancën e mbajtur me datë 28 mars 2019 nxori këtë:

V E N D I M PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "KelKos Energy" SH.P.K., dhe **MODIFIKOHET VENDIMI PËR AUTORIZIMIT FINAL V_568_2013** i datës 24 tetor 2013, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Lumëbardhi II., nga kapaciteti instalues prej 5.5 MW në kapacitetin total instalues prej **6.2 MW**, sipas Vendimit nr. 3681-3/18 –ZSP- /2018 të datës 13.11.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1839/11 – ZSP- 229/13 dt.



19.03.2013 për HC Lumëbardhi II., nga N = 5.5 MW në kapacitetin e ekzekutuar N= 6.2 MW të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).

- II. Vendimi mbi Modifikimin e Autorizimit Final V_568_2013 i datës 24 tetor 2013, sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij Vendimi, modifikon ndryshimin e kapacitetit instalues nga 5.5 MW në kapacitetin total 6.2 MW, ndërsa ndryshimet e projektit sipas Lejen Ndërtimore të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, do të merren parasysh pas pranimit të Certifikatës së Përdorimit të lëshuar nga MMPH.
- III. **OBLIGOHET** - shoqëria “KelKos Energy” SH.P.K., pas përfundimit të punëve ndërtimore sipas dispozitivit nën pikën I. të këtij vendimi, të aplikon për tu pajisur me Certifikatë të Përdorimit pranë organit kompetent të MMPH-së, sipas Ligjit të Ndërtimit.
- IV. Pas finalizimit të projektit sipas dispozitivit nën pikën III. të këtij vendimi, gjeneratori “KelKos Energy” SH.P.K., do të hyn në Operim komercial sipas Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut (KOSTT) në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V_810_2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent (MMPH).
- V. Shoqëria “KelKos Energy” SH.P.K., do të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) nga MMPH.

Arsyetim

- ZRRE, më 09.08.2010 nga shoqëria “KelKos-Energy” SH.P.K. ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji, me kapacitet të instaluar prej 23.1 MW, në lokacionet: HC Lumëbardhi II. me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, HC Belaja me kapacitet të instaluar prej 9.2 MW dhe HC Deçan me kapacitet të instaluar prej 8.4 MW, të gjitha në komunën e Deçanit., Republika e Kosovës.
- Bordi i ZRRE-së pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentralet dhe me datë 11 nëntor 2010 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_296_2010, dhe ka udhëzuar aplikuesin që ti plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë. Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit Final përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE, më 27.09.2013, nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k. ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Uji në Autorizim për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen Ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, më 24.10.2013 ka vendosur që shoqërisë “Kelkos-Energy” sh.p.k. t’i lëshohet Autorizimi V_568_2013 për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, për prodhimin e energjisë elektrike nga Uji, për HC Lumëbardhi II, me kapacitet të



- instaluar prej 5.5 MW, njësia gjeneruese që do të vendoset në lokacionin e lumit Deçan të komunën e Deçanit.
- ZRRE, më 21.10.2015, nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_568_2013, të datës 24 tetor 2013, për HC Lumëbardhi II me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, për kompletimin e ndërtimit edhe për një (1) vit.
 - ZRRE, më 28 janar 2016, ka vendosur me Vendimin V-763-2016 që shoqërisë “ Kelkos _ Energy” sh.p.k. t’i shtyhet afati i vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V-568-2013 i datës 24 tetor 2013 edhe për një afat një (1) vjeçar, gjegjësisht deri më 24 tetor 2016.
 - ZRRE, më 20.10.2016, nga shoqëria “Kelkos-Energy” sh.p.k. ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit për Autorizimin Final V_568_2013, të datës 24 tetor 2013, i vazhduar me Vendimin V-763-2016, të datës 28 janar 2016, për HC Lumëbardhi II, me kapacitet të instaluar prej 5.5 MW, për një afat shtesë për zgjatjen e periudhës së caktuar për përfundimin e ndërtimit edhe për një (1) vit.
 - ZRRE, më 25 nëntor 2016, ka vendosur me Vendimin V-863-2016 që shoqërisë “ Kelkos _ Energy” sh.p.k. t’i shtyhet afati i vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V-568-2013 i datës 24 tetor 2013 edhe për një afat një (1) vjeçar, gjegjësisht deri më 24 tetor 2017.
 - ZRRE me datë 07 dhjetor 2018 nga shoqëria “KelKos Energy” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V_568_2013 të datës 24 tetor 2013 për Modifikimin e Autorizimit Final dhe ndryshimin e kapacitetit instalues nga 5.5 MW në kapacitetin total instalues prej 6.2 MW për Hidrocentralin HC Lumëbardhi II. që është ndërtuar në ngastrën ZK Deçan, Komuna e Deçanit.
 - ZRRE s’bashku me kërkesës për Modifikim të Autorizimit Final ka pranuar dëshmitë dhe atë: Vendimi nr. 3681-3/18 –ZSP- /2018 të datës 13.11.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1839/11 – ZSP- 229/13 dt. 19.03.2013 për HC Lumëbardhi II., nga N= 5.5 MW në kapacitetin e ekzekutuar N= 6.2 MW të lëshuar nga MMPH, Raportin e Reviduar 3 si vlerësim i ndërtimit, amendamentimin e Dizajnit të ndërtimit të HC Lumëbardhi II dhe Projektit Kaskad Hidrologjik i Lumëbardhit të Deçanit. Projekti përfshinë Kablo të energjisë 35 kW, infrastruktura e Hidrocentralit (planimetria e Tubit), projektin kryesor dhe infrastruktura e gjeneratorit.
 - Shoqëria “KelKos Energy” SH.P.K., në kërkesën e saj ka sqaruar se: dizajni origjinal i projektit Lumëbardhi II., është dashur të ndryshohet bazuar në hulumtimet e thella në terren, për shkak të arsyeve gjeologjike dhe hidrologjike. Në raportin e revidimit (vlerësimin e zbatimit të ndërtimit), të përgatitur për MMPH nga ekspertët ndërkombëtarë të njohur për këto lloje të dizajneve të hidrocentraleve, ndryshimet janë analizuar dhe gjetjet e tyre duke iu referuar rrethanave teknike të cilat janë konfirmuar në raport.
 - Poashtu me këto ndryshime të dizajnit, është dashur të pranohet një humbje e konsiderueshme e prodhimit vjetor për më shumë se 30 %, me qëllim të mbulimit të një pjese të kësaj humbjeje të prodhimit vjetor për shkak të kushteve të ndryshme hidrologjike, ku kapaciteti i pikut të HC Lumëbardhi II., është dashur të ndryshohet nga 5.5 MW në 6.2 MW.
 - Gjithashtu në kërkesën e saj ka sqaruar se bazuar në hulumtimet vetanake dhe inspektimet e ndryshme duke përfshirë edhe referencën në raportin e Revidimit, ky ndryshim i kapacitetit është aprovuar nga Ministria e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, konkretisht Departamenti i Ujërave.



- Shoqëria "KelKos Energy SH.P.K., ka sqaruar se me Vendimin nr. 3681-3/18 –ZSP- /2018 të datës 13.11.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1839/11 – ZSP- 229/13 dt. 19.03.2013 për HC Lumëbardhi II., nga N= 5.5 MW në kapacitetin e ekzekutuar N= 6.2 MW të lëshuar nga MMPH, është aprovuar ndryshimi i kapacitetit, dhe poashtu Leja Ujore e ndryshuar është lëshuar në bazë të dokumentacionit investivo – teknik, dhe ndryshimet duhet të jenë në harmoni me kapaciteti ekzistues dhe dislokimi i objektit duhet të mbes në fuqi.
- Andaj, bazuar në këtë që tha më lartë dhe dokumentet e bashkangjitura përfshirë edhe vendimin për ndryshimin e Lejes Ujore të lëshuar nga MMPH në mbështetje të kërkesës, kanë kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 19 të Rregullës së Autorizimit të aprovon modifikimin e autorizimit final dhe të iu mundësohet ndryshimi i kapacitetit instalues nga 5.5 MW në kapacitetin total të ekzekutuar prej 6.2 MW.
- ZRRE me datë 10 dhjetor 2018 iu ka drejtuar me shkrim Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ku ka njoftuar se ZRRE ka pranuar kërkesë për Modifikim të Autorizimit nga shoqëria KelKos Energy SH.P.K., s'bashku me Vendimin nr. 3681-3/18 –ZSP- /2018 (mbi Ndryshimin e kapacitetit Instalues të Hidrocentralit), dhe ka kërkuar nga Ministria përkatëse të konfirmoj ndryshimin e projektit në bazë të Raportit të revizionit.
- ZRRE me datë 22 janar 2019 nga Ministria e Mjedisit ka pranuar përgjigjen me shkrim ku ka sqaruar se "plotësim ndryshimi i Lejes Ndërtimore për HC Lumëbardhi II., nuk është bërë gjatë këtij procesi të ndërtimit, dhe ndryshimi i vetëm është bërë në bazë të analizës së aplikimit nga kompania KelKos SH.P.K., dhe është bërë në Lejen Ujore të Lëshuar nga MMPH", andaj për të plotësuar procesin që ndërlidhet me lejen e ndërtimit ka kërkuar nga ZRRE që të konfirmoj fillimisht aprovimin e Modifikimit të Autorizimit për kapacitetin instalues të gjeneratorit, dhe pastaj të reflektohet në procesin e shqyrtimit të Lejes së përdorimit pas finalizimit të projektit".
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmime të bashkangjitura, ka vlerësuar ato, dhe ka konstatuar se kërkesa për modifikim është e bazuar, dhe dëshmitë e bashkangjitura janë bazë e mjaftueshme për të lejuar Modifikimin e Autorizimit Final V_568_2013 të datës 24 tetor 2013, dhe ndryshimin e kapacitetit instalues nga 5.5 MW në kapacitetin total prej 6.2 MW bazuar në Vendimin nr. 3681-3/18 –ZSP- /2018 të datës 13.11.2018 për ndryshimin e vendimit të Lejes së Ujore me Nr. 1839/11 – ZSP- 229/13 dt. 19.03.2013 për HC Lumëbardhi II., nga N= 5.5 MW në kapacitetin e ekzekutuar N= 6.2 MW të lëshuar nga MMPH, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


VI. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.




Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- KOSTT-it,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.